



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 514/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Srpska Demokratska Stranka Kosova i Metohije me seli në Graçanicë, paraqitur kundër Marinkovic Goran - Glumac nga subjekti politik SLS, për shkak të kërcënimit gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Srpska Demokratska Stranka Kosova i Metohije.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik Srpska Demokratska Stranka Kosova i Meohije, me te cilën pretendohet se në Vendvotimin nr.3405e/01R dhe nr.3405e/02R në fshatin Gushterica e poshtme ka ardhur deri tek prishja e qetësisë publike nga kërcënimet dhe fryrjet që i ka bërë Marinkovic Goran - Glumac nga subjekti politik SLS, në drejtim të nën kryetarit të Srpska Demokratska Stranka Kosova i Meohije.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkakut se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 514/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

